



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 7 Mars 2023

Nr: 97

Ora: 12:00

V E N D I M

P Ë R

**PËR MOSFILLIM TË PROCEDURËS ADMINISTRATIVE NDAJ PREFEKTIT TË QARKUT ELBASAN DHE
PREFEKTIT TË QARKUT SHKODËR, PËR SHKELJE ADMINISTRATIVE NË ZGJEDHJET PËR
ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023**

Sot më datë 7 Mars 2023, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve mori në shqyrtim çështjen administrative me:

SUBJEKT: Zj. Lorena Balliu, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike pranë Prefektit të Qarkut Elbasan
Zj. Felek Kasemi, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike pranë Prefektit të Qarkut Shkodër

KËRKUES: Koalicioni për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK)

OBJEKT: Shqyrtim administrativ ndaj personit përgjegjës pranë Prefektit të Qarkut Elbasan dhe personit përgjegjës pranë Prefektit të Qarkut Shkodër, për raportimin e veprimtarive publike

BAZA LIGJORE: Në mbështetje të nenit 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, nenit 91 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 60, 61 e vijues të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurës Administrative të Republikës së Shqipërisë” vendimit nr. 9, datë 09.03.2021 dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

K O N S T A T O J :

Data: 7 Mars 2023

Nr: 97
Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ ndaj personit përgjegjës të Prefektit të Qarkut Elbasan dhe Prefektit të Qarkut Shkodër, për raportimin e veprimtarive publike”

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, më datë 6.3.2023 në adresën e postës elektronike, të Koordinatorit për të Drejtën e Informimit, ka marrë indicie për organizimin e 2 (dy) veprimtarive publike të ndryshme nga ana e Prefektit të Qarkut Elbasan dhe Prefektit të Qarkut Shkodër.

Indiciet janë marrë nëpërmjet provave ku pretendohet si në vijim:

1. Lidhur me veprimtarinë e zhvilluar nga Prefekti i Qarkut Elbasan: *“Sot, më datë 06.02.2023, nën drejtimin e Prefektes të Qarkut Elbasan zj.Majlinda Perriu, u zhvillua analiza e punës së Institucionit të Prefektit të Qarkut Elbasan për vitin 2022. Në këtë analizë morën pjesë, z. Arben Xhaferri, Drejtori i Drejtorisë së Çështjeve Vendore në Ministrinë e Brendshme, zj.Lindita Mukaj, Përgjegjësja e Sektorit të Koordinimit me Prefekturat dhe Emergjencat në Ministrinë e Brendshme, z.Gazmend Vogli, Specialist i Sektorit të Koordinimit me Prefekturat dhe Emergjencat në Ministrinë e Brendshme.*

Prova link:

<https://www.facebook.com/photo?fbid=495540379433823&set=pcb.495540556100472>

2. Lidhur me veprimtarinë e zhvilluar nga Prefekti i Qarkut Shkodër: *“Në analizën e punës së institucionit të Prefektit për vitin 2022, me pjesëmarrjen e zv .Ministrit të Brendshëm, z. Besfort Lamallari dhe administrata e Prefektit të Qarkut Shkodër analizuam veprimtarinë e institucioneve qendrore në nivel vendor.*

Prova link:

<https://www.facebook.com/photo/?fbid=198328699454942&set=pcb.19832874612160>

4

Neni 19, pika 1, shkronja “dh”, “f” dhe “n” e pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar përcakton kompetencat që ushtron Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.

Mbështetur në përcaktimet e nenit 8, pika 2, të vendimit nr. 9, datë 09.03.2021, të Komisionit Rregullator, pasi shqyrtova paraprakisht çështjen, vlerësoj se informacioni apo të dhënat e treguara nuk krijojnë një bazë të mjaftueshme për të hetuar administrativisht shkeljet e mundshme.

Meqenëse në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, janë paraqitur 2 (dy) indicie nëpërmjet provave link të ndryshme, që i drejtohen subjekteve të ndryshme, por objekti i shqyrtimit bazohet në të njëjtat fakte dhe bazë ligjore, në mbështetje të nenit 65, shkronja “ç” të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, u vendos shqyrtimi së bashku i këtyre indicieve.

Nga verifikimi i provave dhe fakteve, vlerësohet se referuar nenit 91, të Kodit Zgjedhor dhe nenit 3, të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020 të Komisionit Rregullator, veprimtaritë e kryera nga Prefekti i

Qarkut Elbasan dhe Prefekti i Qarkut Shkodër nuk përbëjnë veprimtari publike dhe për rrjedhojë lidhur me këto veprimtari nuk rëndon detyrimi për raportim. Rezulton se këto veprimtari përkojnë me përmbushjen e detyrave funksionale të Prefektit të Qarkut dhe kanë nuk karakter publik por karakter teknik.

Për sa më sipër, në mbështetje të fakteve të administruara rezulton se objekti rast hetimi pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ndaj Prefektit të Qarkut Elbasan dhe Prefektit të Qarkut Shkodër, nuk krijojnë një bazë të mjaftueshme për të hetuar administrativisht shkeljet e mundshme të nenit 92, Kodit Zgjedhor dhe të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f ” dhe “n”, pika 2, nenin 91 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 60 dhe vijues të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve

V E N D O S:

1. Mosfillimin e procedurës administrative ndaj personit përgjegjës për Prefekturën e Qarkut Elbasan dhe Prefekturën e Qarkut Shkodër.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI